


# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7909  
E premte, 18 tetor 2024  
Çmimi 0.50 €

**BB-ja: Ballkani Perëndimor me rritje ekonomike, por parashikimi për të ardhmen i pasigurt** FAQE 4



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

## IKD-ja, KDI-ja DHE KMDLNJ SHPREHIN SHQETËSIM PËR BOJKOTIMIN E SHUMICËS PARLAMENTARE NË SEANCAT E JASHTËZAKONSHME

FAQE 4-5



### AKTUALE



**BOMBARDUESIT AMERIKANË GODASIN BUNKERËT NËNTOKËSORË TË HUTHIVE NË JEMEN** F. 2

**SBASHK-U I GATSHËM TË KONTRIBUOJË NË EDUKIMIN MEDIAL TË NXËNËSVE** F. 3

**KIRURGU AUSTRALIAN OPERON NË KOSOVË FËMIJËT ME PROBLEME TË TRAKTIT GASTROINTESTINAL** F. 5

### EKONOMI



**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA 22 MILIONË EURO PËR ZGJERIMIN E QASJES NË FINANCA PËR BIZNESE** F. 8

**HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR AGROKOS** F. 8

### SPORT



**SUPERLIGA RIKTHEHET ME NDESHJEN GJILANI - FERIZAJ** F. 10

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) kanë shprehur shqetësim të thellë pas bojkotimit të shumicës

parlamentare, përfaqësuar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, në tri seanca të jashtëzakonshme të thirrura nga opozita. Sipas këtyre tri institucioneve, ky bojkot përbën një shkelje të besimit të qytetarëve dhe detyrave dhe

përgjegjësi si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe si partia më e madhe parlamentare. IKD, KDI dhe KMDLNJ konsiderojnë se debatet parlamentare janë shtyllë e rëndësishme e demokracisë dhe përfaqësimit demokratik

**SHEFI I NATO-s: GJENDJA E SIGURISË NË KOSOVË DHE RAJON, E BRISHTË** F. 3



**ALBIN KURTI E HAPI KUTINË E PANDORËS. NUK E MBYLLË MË DOT!** F. 3



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVIÇË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

## Ukraina nxjerr para Perëndimit “Planin e Fitores”

KIEV, 17 TETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, shkoi në Bruksel më 17 tetor për ta paraqitur “Planin e Fitores” me pesë pika, fillimisht para udhëheqësve të Bashkimit Evropian, pastaj para ministrave të Mbrojtjes të NATO-s. Asnjëra prej dy organizatave perëndimore, haptazi, nuk e ka hedhur poshtë planin, dhe është e drejtë të thuhet se ato janë sjellë me dashamirësi ndaj Kievit.

Megjithatë, as pika një, as pika dy nuk japin shpresa. E para përcakton se Ukraina duhet të marrë ftesë për t'u anëtarësuar në NATO, ndërsa e dyta leje për të përdorur armë me rreze të gjatë - të siguruar nga Perëndimi - në territorin rus.

Kievi prej kohësh i kërkon këto dy pika, por nuk ka dritë jeshile.

Ukraina do që ftesën për NATO ta ketë tani, ndërsa anëtarësimi të

bëhet pasi të përfundojë lufta. Në këtë mënyrë, ajo synon ta ulë frikën mes anëtarëve të NATO-s, se mund të tërhiqen në një konfrontim të drejtpërdrejtë me Moskën.

Këtë kërkesë e ka paraqitur edhe në samitin e NATO-s në Vilnius, vitin e kaluar, edhe në samitin e sivjetmë në Uashington.

Në përgjigje, aleanca ushtarake ka konfirmuar se Ukraina do të jetë anëtare dikur në një të ardhme dhe ka dalë me formulime si “ura drejt anëtarësimi” ose “rruga e saj drejt anëtarësimi” është e pakthyeshme.

Kur u pyet për ftesën, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, i tha të njëjtat fjalë dhe nënvizoi gjithçka që organizata e tij bën për vendin e shkatërruar nga lufta.

Ambasadorja amerikane në NATO, Julianne Smith, tingëlloi njësoj e



paangazhuar. Dhe kjo do të thotë se nuk ka asgjë të re. “Nuk kemi lëvizur përtej Vilniusit dhe Uashingtonit”, është refreni i zakonshëm që dëgjohej në NATO. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për lejen për të sulmuar thellë brenda Rusisë. Ky është kryesisht një vendim i ShBA-së dhe duket se

Uashingtoni nuk është i interesuar ta lejojë atë.

Zelensky u kthye duarbosh nga udhëtimi i tij në ShBA në shtator dhe duket se asgjë nuk ka ndryshuar, marrë parasysh edhe faktin se ShBA-ja është në prag të zgjedhjeve presidenciale të 5 nëntorit.

Sa i përket kësaj, edhe mund të ketë leje të kufizuara në të ardhmen, por nuk duhet prituri që ato të paralajmërohen zëshëm nëpër medie.

Me dy pikat e para vështirë të realizueshme, tri të tjerat - frenimi i Rusisë nëpërmjet një pakete parandaluese strategjike jobërthamore të vendosur në tokën ukrainase, mbrojtja e përbashkët nga ShBA-ja dhe BE-ja e burimeve kritike natyrore të Ukrainës dhe zëvendësimi i disa trupave amerikane, të stacionuara nëpër Evropë, me ushtarë ukrainas pas luftës - janë bërë të diskutueshme.

Zelensky e ka ditur gjithmonë se ky do të ishte një pazar i vështirë.

Por, tani për tani, përpara një dimri që pritet të jetë i vështirë dhe rraskapitës, ai ka luajtur kumar, duke e vendosur topin në fushën e Perëndimit.

## Bombarduesit amerikanë godasin bunkerët nëntokësorë të Huthit në Jemen

WASHINGTON, 17 TETOR - Ushtria amerikane ka kryer sulme ajrore me bombardues B-2 ndaj bunkerëve të rebelëve Huthi të Jemenit të enjten në mëngjes, thanë zyrtarët amerikanë.

Nuk është ende e qartë se çfarë dëmsh kanë shkaktuar këto bombardime.

Në të kaluarën nuk është raportuar për përdorimin e bombarduesve B-2 për sulme ndaj rebelëve Huthi, të cilët ka kohë të gjatë që i sulmojnë anijet në Detin e Kuq për shkak të luftës në Rripin e Gazës mes Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja.

Kanali satelitor i lajmeve i Huthit, al-Masirah, raportoi për sulme ajrore rreth kryeqytetit të Jemenit, Sana, të cilin ky grup e ka nën kontroll prej vitit 2014. Ai gjithashtu raportoi për sulme rreth



bastionit të Huthit në Sada. Ky kanal nuk tregoi nëse kishte dëme apo viktima.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha në një deklaratë se bombarduesit B-2 kishin në shënjestër “pesë vende të fortifikuara nëntokësore për ruajtjen e armëve në zonat e kontrolluara nga Huthi në Jemen”.

Ky sulm duket se gjithashtu ishte paralajmërim tërthor për Iranin, mbështetësin kryesor të rebelëve Huthi, i cili ka sulmuar Izraelin me raketa balistike dy herë gjatë vitit të kaluar. Bombarduesit B-2 do të përdoren në çdo sulm amerikan ndaj objekteve të fortifikuara bërthamore të Iranit si, Natanz ose Fordo, duke qenë se

është i vetmi avion luftarak i cili mund të hedhë bomba GBU-57. “Ky ishte një demonstrim i veçantë i aftësive të Shteteve të Bashkuara për t'i goditur objektet që armiqtë tanë përpiqen t'i mbajnë larg arrijtes sonë, pavarësisht se sa thellë janë futur, fortifikuar apo blinduar”, tha Austin.

Komanda Qendrore e ShBA-së tha në një deklaratë se vlerësimet fillestare tregojnë se nuk ka civilë të vrarë.

Deti i Kuq është bërë fushëbetejë për anijet tregtare prej se rebelët Huthi filluan të kryejnë sulme ndaj anijeve që kalojnë përmes rrugës ujore, nëpër të cilën dikur kalonin mallra në vlerë 1 trilion dollarë në vit.

Huthët kanë sulmuar më shumë se 80 anije tregtare me raketa dhe dronë prej kur filloi lufta në Gaza në tetor 2023. Ata kanë kapur një anije dhe kanë fundosur dy gjatë

fushatës së tyre, si pasojë e të cilës gjithashtu janë vrarë katër detarë. Raketa dhe dronë të tjerë janë rrëzuar nga një koalicion i udhëhequr nga ShBA-ja në Detin e Kuq, ose kanë dështuar të arrijnë objektivat e tyre, të cilat përfshijnë anije ushtarake perëndimore.

Rebelët pretendojnë se ata kanë në shënjestër anijet e lidhura me Izraelin, ShBA-në ose Mbretërinë e Bashkuar, në përpjekje për t'i dhënë fund luftës së Izraelit kundër Hamasit në Gazë. Megjithatë, shumë nga anijet e sulmuara kanë pak ose aspak lidhje me konfliktin.

Bombarduesi B-2, i cili për herë të parë u përdor në luftime në luftën e Kosovës më 1999, përdoret rrallëherë nga ushtria amerikane në luftime, pasi një avion i tillë kushton rreth 1 miliard dollarë.

Ky avion ka hedhur bomba në Afganistan, Irak dhe Libi.

## Kthehen në Itali katër migrantë që u strehuan në Shqipëri

TIRANË, 17 TETOR - Katër migrantë, që kishin shkuar në Shqipëri më 16 tetor nga Italia, janë kthyer mbrapsht në Itali, konfirmuan autoritetet shqiptare për Radion Evropa e Lirë.

Drejtori i portit të Shëngjinit, Sander Marashi, tha se migrantët që u larguan nga Shqipëria ishin dy të mitur dhe dy të tjerë që kishin probleme shëndetësore.

Një ditë më parë, anija italiane Libra, u ankorua në portin e Shëngjinit me 16 migrantë në bord, të cilët Shqipëria ka pranuar t'i strehojë.

Dhjetë migrantë ishin nga Balgadeshi dhe gjashtë nga Egjipti,

të cilët ishin shpëtuar në det pas nisjes nga Libia.

Shqipëria dhe Italia nëntorin e vitit të kaluar kanë arritur marrëveshje për strehimin e migrantëve. Marrëveshja, që është kritikuar nga organizatat për të drejtat e njeriut, parasheh që Shqipëria do të pranojë deri në 36.000 migrantë në vit, dhe aplikacionet e azilit të këtyre migrantëve do të procesohen në dy qendra në Shqipëri.

Marrëveshja pesëvjeçare është thënë se do t'i kushtojë Italisë 160 milionë euro në vit.

Kryeministrja italiane Giorgia Meloni e ka përshkruar



marrëveshjen me Shqipërinë si zgjidhje inovative për një problem

afatgjatë. Sipas marrëveshjes, procedurat për migrantët do të

kryhen në dy qendra.

Qendra e parë në Shëngjin do të përdoret për procedura të identifikimit të migrantëve, ndërsa qendra e dytë, në Gjadër, rreth 20 kilometra larg portit, do të shpërbëjë për strehim të migrantëve derisa të procesohen kërkesat për azil.

Qendrat do të funksionojnë sipas ligjit italian, me staf italian të sigurisë, ndërsa gjyqtarët do t'i mbajnë seancat përmes videolidhjes nga Roma.

Italia ka thënë se do të pranojë t'i strehojë migrantët që fitojnë azil, ndërsa ata që nuk fitojnë azil do të dëbohen nga Shqipëria.

# IKD-ja, KDI-ja dhe KMDLNj shprehin shqetësim për bojkotimin e shumicës parlamentare në seancat e jashtëzakonshme

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) kanë shprehur shqetësim të thellë pas bojkotimit të shumicës parlamentare, përfaqësuar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, në tri seanca të jashtëzakonshme të thirrura nga opozita. Sipas këtyre tri institucioneve, ky bojkot përbën një shkelje të besimit të qytetarëve dhe detyrave dhe përgjegjësi si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe si partia më e madhe parlamentare. IKD, KDI dhe KMDLNj konsiderojnë se debatet parlamentare janë shtyllë e rëndësishme e demokracisë dhe përfaqësimit demokratik



rrugën e saj drejt integritimit evropian.

Edhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka reaguar duke theksuar se në javën e fundit, posaçërisht sfidues për punën e Kuvendit ka qenë bojkotimi i seancave plenare nga shumica parlamentare, në rastet kur opozita ka propozuar diskutime ose ka thirrur seanca të jashtëzakonshme për tema të rëndësishme. “Është e paprecedentë që bojkoti si instrument politik parlamentar shfrytëzohet nga partitë në pushtet, të cilat, në fakt, do të duhej të ishin përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e punimeve plenare të Kuvendit. I papranueshëm është edhe veprimi i kryetarit Glauk Konjufca për ta shmangur udhëheqjen e seancave të fundit të thirrura nga opozita - përkundër që ky përbën një obligim të tij kushtetues”, thuhet në reagimin e KDI-së.

Edhe KMDLNj ka theksuar se bojkotimi i seancave të Kuvendit, papërgjegjësi institucionale dhe ligjore. KMDLNj dënon çdo bojkotim të seancave të Kuvendit të Kosovës dhe kërkon që ndaj deputetëve abuzues të ndërmerren masa pavarësisht prej përkatësisë etnike dhe politike.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 17 TETOR** - Opozita parlamentare në Kuvendin e Kosovës ka thirrur tri seanca të jashtëzakonshme për tema me interes publik si për qytetarët ashtu edhe për funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Seancat janë thirrur për çështjet: Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, me Milan Radojiçiq; Debat parlamentar për mungesën e ushqimit në Ushtrinë e Republikës së Kosovës; Debat parlamentar për procesin e

përlogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit dhe mënyrës së shlyerjes së këtyre borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Përkundër interesit publik për debat parlamentar për çështjet e lartpërmendura, shumica parlamentare, e përfaqësuar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje!, ka refuzuar të marrë pjesë në seancat e jashtëzakonshme, pa asnjë arsytim legjitim dhe të besueshëm. Ky bojkot përbën një shkelje të besimit të qytetarëve dhe detyrave dhe përgjegjësi si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe si partia më e madhe

parlamentare. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) shpreh shqetësim të thellë për këtë situatë dhe kërkon nga LV-ja të largohet nga rruga e bojkotit kundërkushtetues. Kjo praktikë dhe qasje e LV-së është e pazakontë dhe cenon rëndë vlerat demokratike të Republikës së Kosovës. IKD-ja konsideron se debatet parlamentare janë shtyllë e rëndësishme e demokracisë dhe përfaqësimit demokratik, deputetët e shumicës parlamentare e kanë obligim të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e çështjeve që prekin interesat e qytetarëve dhe të shtetit. “Bojkoti i seancave

parlamentare dëmton jo vetëm integritetin e Kuvendit, por edhe injorim ndaj qytetarëve të Kosovës”, është thënë në reagimin e IKD-së. Më tej theksohet se, pavarësisht prej përkatësisë partiake, deputetët duhet t'i ruajnë dhe promovojnë vlerat bazë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës. Instituti i Kosovës për Drejtësi bën thirrje që të gjitha partitë politike, pa dallim, t'i përmbushin detyrimet e tyre që rrjedhin nga Kushtetuta e Kosovës, ligjet e aplikueshme dhe obligimet ndaj qytetarëve të Kosovës dhe vlerave demokratike që Republika e Kosovës i ka marrë përsipër në

## Shefi i NATO-s: Gjendja e sigurisë në Kosovë dhe rajon, e brishtë

**PRISHTINË, 17 TETOR** - Shefi i ri i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë të mërkurën se gjendja e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor është e brishtë, duke përmendur në veçanti atë në Kosovë dhe në Bosnjë-Hercegovinë. “Situata në Ballkanin Perëndimor mbetet shqetësuese me kërcënimet për ndarje në Bosnjë-Hercegovinë, situatën e brishtë të sigurisë në Kosovë dhe përparimin e vogël në dialogun e lehtësuar nga BE në mes të Beogradit dhe Prishtinës”, tha Rutte për gazetarë në prag të takimit të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s. Gjendja e sigurisë në Kosovë



mbetet e tensionuar prej vitit të kaluar, veçanërisht pas një sulmi nga një grup serbësh ndaj Policisë së Kosovës në veri të vendit, si pasojë e të cilit u vra një polic dhe tre sulmues. Së voni, NATO-ja ka zhvendosur trupa në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, duke thënë

se ata dërgojnë “mesazh të qartë” të vendosmërisë të fortë të NATO-s dhe përkushtimit për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në rajon, por edhe aftësitë e aleancës dhe gatishmërinë për t'u përgjigjur. Rutte u zotua se NATO-ja do të mbetet fuqishëm e përkushtuar për misionin e vet në Kosovë, KFOR, i cili ka mbi 4 400 trupa ushtarake në vend. “Për më shumë se dy dekada KFOR-i ka ruajtur një ambient të qetë dhe sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes. Përkushtimi i NATO-s për KFOR-in mbetet i fuqishëm edhe sot”, theksoi Rutte.

NATO-ja e ka shtuar praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës që është e para dhe pas misionit të BE-së për sundim të ligjit, EULEX. Misioni i NATO-s në Kosovë, po ashtu, është përgjegjës për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë, ndërsa pjesën tjetër të vijës kufitare e mbikëqyr Policia e Kosovës. Rutte, ish-kryeministër i Holandës, para dy javësh e mori përsipër rolin e sekretarit të

përgjithshëm të NATO-s duke e pasuar në këtë post ish-shefin e aleancës, Jens Stoltenberg. Ai foli edhe për përpjekjet e Rusisë për të krijuar ndasi në rajon përmes fushatave dezinformuese. “Rusia, po ashtu, po bën përpjekje për ta penguar demokracinë në rajon me kërcënime hibride dhe kibernetike, përfshirë edhe dezinformimin. Ajo po përdor ndjesitë e brendshme për të krijuar ndasi”, nënvizoi ai. Ky do të jetë takimi i parë i Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel të ministrave të Mbrojtjes nën udhëheqjen e Ruttës.

## SBASHK-u i gatshëm të kontribuojë në edukimin medial të nxënësve

**PRISHTINË, 17 TETOR** - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) e ka parë me shqetësim fenomenin e lëndimit të nxënësve nëpër shkollat e Kosovës, nisur nga trendë të ndryshëm nëpër medie sociale. Duke parë se nxënësit me të madhe po i përdorin mediet sociale, SBASHK-u në bashkëpunim me profesorë të Departamentit të Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës kishte përgatitur një program trajnimi për edukimin medial, që u dedikoi mesimdhënësve me qëllim që ata të marrin njohuri


të reja për rolin e medieve dhe ato njohuri t'i bartin te kolegët, por më shumë te nxënësit e tyre. “Ky trajnim ishte licencuar nga Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve dhe mbahej nga profesorë të nderuar të gazetarisë. Ky trajnim kishte zgjuar interesim të madh te mesimdhënësit dhe organizohej me mjete modeste të SBASHK-ut falë angazhimit, thuaja vullnetar, të profesorëve të gazetarisë. Duke e ditur rëndësinë e edukimit medial, SBASHK-u dhe profesorët e Departamentit të Gazetarisë po trasonin rrugën që të përgatiten



kuadro dhe edukimi medial të jetë një nga lëndët zgjedhore. Tanimë, duke parë nevojën e nxënësve që të fitojnë shkathtësi për t'u përballur me rreziqet që shfaqen nga përdorimi i

medieve sociale, i bëjmë thirrje Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, që ta ndryshojë kurrikulën dhe ta shndërrojë lëndën e Edukimit Medial në lëndë obliguese në

sistemin parauniversitar. Ky ndryshim mundëson që nxënësit të jenë më të shkathtë dhe më të mbrojtur nga rreziqet potenciale që shfaqen në mediet sociale të cilat kanë një përdorim të gjerë te fëmijët. SBASHK-u shprehet i gatshëm të kontribuojë edhe më tutje në këtë çështje, duke ofruar aspektin organizativ dhe përmes profesionistëve aspektin përmbajtësor ta riorganizojë trajnimin e edukimit për median, në rast të rilicencimit të tij nga MASHT-1, është theksuar në komunikatën e SBASHK-ut.



## BB-ja: Ballkani Perëndimor me rritje ekonomike, por parashikimi për të ardhmen i pasigurt

Në Kosovë rritja ekonomike është 3.8 për qind, kryesisht e nxitur nga konsumi dhe investimet e diasporës në ndërtime. Sfida kryesore për Kosovën, sipas raportit, mbetin reformat në sektorin e energjisë, furnizimi me ujë dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor, por edhe lidhjet me tregjet e jashtme

Prishtinë, 17 tetor - Banka Botërore vlerëson se shumica e ekonomive të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor përjetuan rritje të moderuar ekonomike gjatë këtij viti, por paralajmëron se parashikimi për të ardhmen mbetet i pasigurt. Sipas raportit të fundit të Bankës Botërore, me titull "Ruajtja e ritmit të rritjes", në tërësi rajoni pritet të shënojë rritje ekonomike prej 3.3-përqindësh në vitin 2024, krahasuar me 2.6 në vitin 2023 dhe kjo rritje e "moderuar" pritet të vazhdojë përgjatë vitit 2025, thuhet në raport.

Rritja e përgjithshme ekonomike në rajon parashikohet të arrijë në 3.7 për qind gjatë vitit 2025, sipas Bankës Botërore. "Përkundër parashikimeve pozitive, rajoni mbetet i brishtë" për shkak të rritjes së dobët ekonomike botërore, inflacionit, pasigurisë politike dhe motit ekstrem, thuhet në deklaratën e Bankës

Botërore të publikuar të enjten. Në raportin mbi rritjen ekonomike dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në të, Kosova, Serbia, Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedonia e Veriut kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2023. Shqipëria ka përjetuar të njëjtin nivel të rritjes ekonomike si në vitin 2023, ndërsa Mali i Zi është i vetmi vend që ka rënie ekonomike në rajon, nga 6.3 për qind në 2023-n, në 3.4 për qind në vitin 2024.

Sipas Bankës Botërore, në vitin 2024 Shqipëria pati rritje ekonomike prej 3.3-përqindësh, njësoj si vitin e kaluar, e nxitur kryesisht nga konsumi, turizmi dhe ndërtimet.

Shkalla e varfërisë, sipas raportit, pritet të zbutet, ndërkohë që pagat do të vazhdojnë të rriten. Aktualisht, sipas Bankës Botërore, 21.7 % e popullsisë në Shqipëri jeton në varfëri, punësimi ka shënuar rritje mbi 1 % dhe pagat në sektorin privat

kanë shënuar rritje prej 12.7 %. Investimet e huaja në Shqipëri gjatë vitit 2024 janë rritur 8.5 % krahasuar me një vit më parë. Sfidat kryesore për Shqipërinë mbeten rënia e numrit të popullsisë për shkak të emigracionit, cilësia e dobët e forcës së punës dhe vendeve të krijuara të punës, si dhe kryerja e reformave strukturore jo me ritmin e nevojshëm, thuhet në raport.

Në Kosovë rritja ekonomike është 3.8 për qind, kryesisht e nxitur nga konsumi dhe investimet e diasporës në ndërtime. Sfidat kryesore për Kosovën, sipas raportit, mbetin reformat në sektorin e energjisë, furnizimi me ujë dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor, si dhe lidhjet me tregjet e jashtme.

Në mesin e rreziqeve, Banka Botërore thekson trysninë për rritjen e shpenzimeve buxhetore në prag të zgjedhjeve, por edhe pasigurinë e vazhdueshme gjeopolitike, përfshirë në kontekstin e veçantë politik të Kosovës. Në rajon rritjen më të madhe ekonomike, sipas Bankës Botërore, e shënoi Serbia, me 3.8 për qind, apo 1.3 për qind më të madhe se ajo e vitit 2023 për shkak të investimeve dhe shtimit

të konsumit të brendshëm. "Rritja ekonomike gjatë vitit 2024 është rezultat i politikave stimuluese fiskale, rritjes së mundësive për huamarrje dhe masave për ta kontrolluar ngritjen e çmimeve, të cilat kanë çuar në rritje të konsumit dhe investimeve", thuhet në raportin e fundit të Bankës Botërore.

Megjithatë, sipas raportit, rritja e vogël ekonomike në vendet partnere evropiane ka çuar në uljen e kërkesave për eksporte dhe shërbime nga rajoni, kryesisht në sektorin e turizmit. "Pasiguria që lidhet me rënien e kërkesës nga vendet e BE-së për eksporte dhe ndikimi i saj në rajon mbetet i lartë. Ruajtja e nivelit të tanishëm të rritjes ekonomike kërkon një kombinim reformash strukturore dhe integrim më të afërt ekonomik të vendeve të rajonit", thuhet në raport.

Në parashikimet e Bankës Botërore, rritja ekonomike në vendet e rajonit deri në vitin 2026 do t'i pasqyrojë prirjet e deritashme. Shqipëria pritet të ketë një rritje prej 3.4-përqindësh në vitet 2025 dhe 2026, ndërsa Kosova 3.9 dhe 4 për qind.

Rritja e dobët ekonomike në Bashkimin Evropian, sidomos në

Gjermani, po ndikon në pasigurinë e përgjithshme ekonomike të rajonit si dhe në rritjen e deficitit buxhetor, sipas Bankës Botërore. Raporti vlerëson se dërgesat nga diaspora në vitin 2024 do të shënojnë ngecje. Sipas raportit, deficitit buxhetor i shteteve të rajonit parashikohet të thellohet më tej gjatë këtij viti, duke arritur në 2.5 për qind të Prodhimit të Përgjithshëm Kombëtar, kryesisht për shkak të zgjerimit të skemave të pensioneve, pagave dhe sigurimeve shoqërore. "Kërkesat e dobësuara për eksporte nga jashtë, krahas çmimeve të larta të energjisë elektrike dhe rritjes së pamjaftueshme të tregut të punës në BE, që ndikojnë te dërgesat e diasporës, kanë çuar në përkeqësimin e gjendjes buxhetore", thuhet në raportin e Bankës Botërore.

Shkalla e punësimit në mbarë rajonin, (grupmosha mbi 15 vjeç e aftë për punë), sipas raportit, ka shënuar përmirësim, duke arritur në 48.5 për qind këtë vit, apo vetëm gjashtë pikë më poshtë se shkalla e punësimit në shtetet anëtare të BE-së, por edhe në këtë aspekt rritja nuk është e njëtrajtshme në të gjitha vendet. Kosova vazhdon të ketë

## Kirurgu australian operon në Kosovë fëmijët me probleme të traktit gastrointestinal

PRISHTINË, 17 TETOR - Për herë të katërmbëdhjetë, në mision për t'i operuar fëmijët me probleme të traktit gastrointestinal, në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve po qëndron profesor Paddy Dewan nga Australia. Gjatë misionit të tij për t'i ndihmuar fëmijët e Kosovës, me ç'rast parashihet të operohen 15 fëmijë me diagnoza të ndryshme. Për ta falënderuar për punën

dhe kontributin e dhënë, profesor Dewanin në takim e pritën drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, u.d. drejtori i përgjithshëm i QKUK-së, Osman Hajdari dhe dr. Ardian Shefkiu. Në takim ishte i pranishëm edhe u. d. drejtori i Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve, dr. Sejdi Statovci. Nga misionet e deritanishme të profesor Dewan, deri tani kanë përfituar mbi 350 fëmijë.



## Vdiq Tina Kaidanow, ambasadorja e parë amerikane në Kosovë

PRISHTINË, 17 TETOR - Diplomati amerikane Tina Kaidanow, që shërbeu si ambasadorja e parë e Shteteve të Bashkuara në Kosovën e pavarur, vdiq të mërkurën, në moshën 59-vjeçare. Ambasadorja Kaidanow ishte

emëruar në muajin korrik të vitit 2006 në pozitën e sheshe të Zyrës së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, Kaidanow u emërua ambasadore. Më 8 prill të vitit 2008, Zyra

Amerikane u shndërrua në Ambasadë të Shteteve të Bashkuara në Kosovë. Udhëheqës të institucioneve dhe partive politike në Kosovë shprehën ngushëllime për vdekjen e diplomates amerikane.

## RrGK i shkruan Konjufcës, kërkon zgjidhje për grevistet e Kuvendit

PRISHTINË, 17 TETOR - Rrjeti i Grave të Kosovës i ka dërguar letër kryekuvendarit Glauk Konjufca përmes së cilës kërkon zgjidhje urgjente për gratë greviste të Kuvendit. "Në emër të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) dhe si aktiviste të përkushtuara për të drejtat e grave, po ju drejtohem me shqetësim të thellë për situatën e punëtoreve teknike të Kuvendit të Kosovës që gjenden në grevë që 32 ditë. Ky ngërç neve na ka shqetësuar dhe zemëruar jashtëzakonisht shumë, duke e reflektuar një mosvlerësim të papranueshëm ndaj kontributit të tyre", thuhet në reagimin e RrGK-së. Mes të tjerash, RrGK kërkon që me

urgjencë të adresohen kërkesat e grevisteve. "Sot po ju kërkojmë me urgjencë që, si institucion, të ndërmerri hapa konkretë për të adresuar kërkesat e tyre dhe të gjeni një zgjidhje të menjëhershme për këtë situatë, sepse pa dyshim që një zgjidhje duhet të jetë! Kjo çështje kërkon vëmendje të menjëhershme dhe zgjidhje të përgjegjshme nga ana juaj, si kryetar i këtij institucioni ku ato japin kontributin e tyre. Jemi në pritje të veprimeve tuaja", thuhet në letër. Punëtorët teknike të Kuvendit kanë hyrë në grevë mbi një muaj më parë me kërkesën për rritje të pagave.



numrin më të madh të të papunëve, me vetëm 37 % të popullsisë së aftë për punë të punësuar. Në Shqipëri, në fund të vitit 2023, shkalla e punësimit ishte 66.7 %. Zbutja e varfërisë, sipas raportit, ka vazhduar në tërë rajonin, por shkalla e uljes së saj është më e ngadaltë se para pandemisë, kryesisht për shkak të rritjes më të ngadaltë ekonomike dhe rritjes së çmimit të prodhimeve ushqimore gjatë viteve të fundit. Në përgjithësi, Banka Botërore parashikon një zbutje të varfërisë 1 % çdo vit. Sipas raportit të Bankës, konsumi

dhe investimet pritet të luajnë rol më të rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë viteve të ardhshme, ndërkohë që importi do ta tejkalojë eksportin. Shqipëria dhe Serbia kanë shënuar rritjen më të mirë ekonomike në rajon të nxitur nga investimet. Në Shqipëri rritja po nxitet nga ndërtimet si dhe klima e përmirësuar e të bërit biznes, sipas raportit. Banka Botërore e vlerëson planin e ri të BE-së për Ballkanin Perëndimor si hap pozitiv që mund ta mbështesë rritjen ekonomike të rajonit, njëkohësisht paralajmëron që

ekzistojnë rreziqe të vazhdueshme, siç janë "rritja e ngadaltë botërore, rritjet e çmimeve, pasiguria politike dhe dëmet nga moti ekstrem". Raporti bën thirrje për reforma të tregut të punës, në veçanti për shtimin e përfshirjes së grave në të. Banka Botërore, po ashtu, veçon migracionin në rajon, i cili, sipas saj, është vendi më i madh i origjinës së emigrantëve në botë në raport me popullsinë, me 1 në katër banorë që jetojnë jashtë vendit. Në këtë kategori, Bosnja dhe Shqipëria janë shtetet me numrin më të lartë të emigrantëve nga rajoni, me rreth

një të tretën e banorëve që kanë braktisur vendet e tyre në kërkim të një vendi pune. Sipas raportit të Bankës, ndërkohë që banorët e rajonit janë larguar nga vendet e tyre, ata janë zëvendësuar me punonjës të huaj që po plotësojnë kërkesat e tregut të punës. "Në periudhën në mes vitit 2000 dhe 2020, popullsia ka shënuar rënie me 8 për qind, apo 1.2 milion banorë", thuhet në raportin e Bankës, duke shtuar se prirje të tilla do të vazhdojnë në të ardhmen dhe nxitur vendet e rajonit të hartojnë politika për t'i angazhuar emigrantët për të kontribuar në ekonomitë e

vendeve të tyre të origjinës. Për ta përshpejtuar qëndrueshmërinë ekonomike, Banka Botërore thotë se është i nevojshëm një integrim më i madh ekonomik i rajonit. "Për ta nxitur këtë rritje, shtetet duhet ta shtojnë tregtinë rajonale dhe me BE-në, ta shkurtojnë kohën e pritjes në kufi dhe t'i integrojnë sistemet e pagesave... Për të kaluar nga statusi (i vendeve) me të ardhura mesatare në atë të vendeve me të ardhura të larta, është thelbësor të përmirësohen sistemet arsimore dhe shëndetësore", thuhet në raport. (Voa)

ADOLF HITLERI: JETA, MIZORITË DHE VDEKJA E TIJ (4)

# Milloseviqi dhe Stalini e kishin karakterin vrastar të Hitlerit

Edhe në fillim të shekullit XXI vazhdojnë të jenë të hapura pyetje të ndryshme lidhur me rrethanat shoqërore, historike, politike, kulturore, psikologjike etj. të paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën botërore. Në këtë kuptim, me të drejtë shtrohen pyetjet: Cila ishte parahistoria e paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën politike? Cilat ishin parakushtet historike, kulturore etj. që mundësuan paraqitjen e nazizmit si ideologji dhe lëvizje politike dhe ushtarake? Çfarë lloj njeriu mund të planifikonte dhe të zbatonte plane dhe projekte aq vdekjeprurës për njerëzimin? Megjithatë, Adolf Hitlerit, diktatorit më të rrezikshëm të shekullit të XX, nuk i dihet varri, ndërsa në vendin e tij në Gjermani nuk ka përmendore!



Shkruan:  
Prof. dr. Agim ZOGAJ

## Nënshkrimi i Paktit Hitler - Stalin

I trimëruar edhe me këtë fitore, Hitleri, po në vitin 1939 doli me pretendimin për Danzingun dhe kërkoi modifikimin e Korridorit Polak. Danzingu ishte një qytet krejtësisht gjerman. Në të vërtetë mbasi Gjermania pushtoi Çekoslovakinë, opinionin publik britanik shpresonte se nuk do të lejoheshin më koncesione: tani e tutje shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore ishte çështje kohe - veç në rast se Hitleri nuk vepronte, që psikologjikisht për te ishte e pamundur.

Në gusht të vitit 1919, Hitleri me Stalinin nënshkruan Paktin për mossullim midis Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik. Të dy diktatorët u morën vesh se si ta ndajnë Poloninë, e cila vetëm 9 ditë pa nënshkrimin të këtij Pakti u sulmua nga Gjermania kurse pas 16 dite u sulmua edhe nga Bashkimi Sovjetik.

Megjithatë, Hitleri i cili frikën më të madhe ia kishte Bashkimit Sovjetik, që nga fundi i muajit korrik 1940 i kishte dhënë urdhër shtatmadhorisë të përpunonte planin e operacioneve për fushatën kundër Bashkimit Sovjetik, të parashikuar për pranverën e vitit 1941. Në luftën kundër Anglisë, Hitleri përjetoi humbjet e para luftarake, por megjithatë, kur pakti Hitler - Stalin, më në fund u prish më 1941, shpërtheu lufta më e madhe tokësore në historinë e deriatëhershme të njerëzimit.

Në mbrëmjen e 21 qershorit 1941, Hitleri e informoi Musolonin se kishte marrë

vendim ta shkatërronte Bashkimin Sovjetik. Të nesërmen, ushtritë gjermane, më tepër se tre milionë, sulmuan në gjithë gjatësinë e frontit sovjetik. Më në fund Hitleri filloi luftën që gjithmonë e kishte dashur. Dhe ai kishte vulosur fundin e tij. Gjermania po zhvillonte luftë të pabarabartë, duke luftuar në dy fronte. Rreth 70 milionë gjermanë ishin angazhuar në luftë kundër 700 milionë kundërshtarëve, qëkurse Hitleri bëri që Amerika të hynte në luftë në dhjetor të vitit 1941. Çuditërisht, Hitleri e ndjente një pasiguri në sulmin ndaj Bashkimit Sovjetik, prandaj vetëm një orë para fillimit të sulmit kishte thënë: "Më duket sikur po shtyj portën në një dhomë të errët, që kurrë se kam parë më parë, pa e ditur se çka pas kësaj porte".

## Testamenti dhe pranimi i humbjes së luftës

Gjatë viteve të fundit të jetës së vet, Hitleri e ndjente dëshpërimin e disfatës së madhe historike për të dhe për popullin gjerman. Ai shpalli se, në qoftë se Gjermania do ta humbiste luftën, faji nuk ishte i tij, por i popullit të vet. Në kohën kur i kishte informatat se Wermacht, ushtria

gjermane kishte ngecur para Moskës ai i kishte thënë një vizitori danez: "Në qoftë se populli gjerman nuk e ka forcën e vetëmohimit për të sakrifikuar gjakun për të mbijetuar, atëherë le të shkatërrohet nga një fuqi tjetër më e fortë se ai".

Më 16 janar 1945 Hitleri u kthye në Berlin, të cilin nuk e braktisi më. Në vendstrehimin e tij nëntokësor, bënte jetën e një të burgosuri, por megjithatë mbetej Fyrieri, i cili ushtrinë gjithnjë magjinë e vet mbi gjermanët dhe vazhdonte luftën kundër gjithë botës. Më 30 janar, ditën e marrjes së pushtetit, ai mbajti fjalimin e fundit, që u dha me anë të radios.

Por, Hitleri përpiquej ende të vepronte nga vendstrehimi i tij i nëndheshëm. Është për t'u theksuar se, në pastet e dëshpërimit Hitleri konkretisht në muajin shkurt i kishte diktuar Bormanit shënimet e veta në të cilat përpiquej të shfaqësohej. Sipas tij, ai kishte bërë përpjekje që të ruaj paqen, se ishte kundër luftës porse armiqët e kishin detyruar të bënte luftën. Hitleri madje kishte shtuar: "Unë gjithnjë e kam dashur paqen. Ne u detyruam të hidhemi në luftë, sepse kështu e donte vullneti i kundërshtarëve...".

Por, në fund të shënimeve të tij, Hitleri parashikonte: "në rastin e disfatës gjermane dhe në pritje të rritjes së nacionalizmave aziatike, afrikane e mbase dhe amerikano - jugore, në botë do të mbeteshin vetëm dy fuqi të afta për të përballur njëra - tjetrën në fushën ushtarake, si dhe thjesht në planin ekonomik dhe ideologjik". Prilli ishte muaji i fundit, muaji i rekrutëve të fundit kur u mobilizuan deri pesëmbëdhjetëvjeçarët dhe adoleshentët, si dhe muaji i vdekjes së papritur të Ruzveltit. Në të njëjtin muaj, derisa po zhvillohej Konferenca e San Franciskos, Hitlerin e mbante iluzioni i fundit se ndoshta mund

të dilnin mosmarrëveshje mes amerikanëve dhe sovjetikëve. Në këtë kohë, Goeringu, Himleri, Speri, Ribbentropi e kishin braktisur, pasi ia kishin uruar ditëlindjen më 20 prill. Ai mbeti i rrethuar nga Eva Braun, dashnorja e tij besnike, Goebbelsi dhe Bormani, si dhe sekretaret dhe punonjësit e sigurimit.

Më 28 prill, ai filloi të marrë masat e fundit dhe diktoi një testament në dy pjesë, private dhe publike. Pas kësaj, i habiti besnikët e vet kur i lajmëroi se, para se të vdiste, do të vinte kurorë me Eva Braun. Ceremonia e vënies së kurorës u pasua nga një darkë që zgjati deri natën vonë.

## Vetëvrasja: 30 prill, 1945 ora 15: 30

Të nesërmen, me 29 prill, Hitleri u ngrit vonë, me humor mjaft të mirë. Pas dreke ai sakrifikoi qenin e vet të preferuar "Blondi" për të provuar forcë veprimi kishin pilulat me helm që do të përdorte. Ai u kërkoi njerëzve të tij të sigurimit të kujdeseshin që trupi i vetë dhe i Evës të digjeshin në mënyrë që të shmangej mundësia që, pas vdekjes, kufomat e tyre të ekspozoheshin në publik nga rusët. Më 30 prill 1945, në orën 3: 30 atë pasdite, ai dhe bashkëshortja e tij shkuan së bashku në studion e tij. Goebbelsi, Bormani dhe bashkëpunëtorët e tjerë të tij të ngushtë prisnin jashtë. Asnjë tingull nuk u dëgjua përmes derës së trashë metalike, por pas dhjetë minutash, burrat e hapën atë dhe hynë brenda.

Brenda ata gjetën Hitlerin dhe Evën të ulur pranë njëri - tjetrit mbi një kanape të vogël. Ajo kishte rënë në të majtë të Hitlerit, kurse Hitleri kishte rënë përpara, mbi një tavolinë të ulët. Në tëmthin e tij të djathtë kishte një vrimë plumbi dhe pistoleta e tij - e njëjta që kishte mbajtur qysh në vitet 1920 - kishte rënë në

dyshe me pranë këmbëve të tij. Në të djathtë të kanapesë, mbi një komodinë, ndodhej një nga artikujt e paktit personal të dhomës: një fotografi e nënës së Hitlerit kur kishte qenë vajzë e re. Më 1 maj 1945 edhe Gebbelsi bashkë me të shoqen vrau veten, pasi u bënë të gjashtë fëmijëve të tyre inxheksione vdekjeprurëse.

Në Gjermani, në vendin të cilin Hitleri e udhëhoqi me grusht të hekurt nga vitin 1933 deri më 1945, nuk gjendet asnjë përmendore e Adolf Hitlerit. Dhe vizitorët nuk mblidhen në varrin e tij, sepse askush nuk e di se ku janë varrosur mbetjet e tij, nëse ato janë varrosur ndonjëherë. Ndoshta hiri, ashtu si edhe kafka, kanë mbetur të mbyllura në një arkivë në Rusi. Ose ndoshta era i ka shpërndarë vite më parë në ndonjë zonë të panjohur të Evropës Lindore.

Duket se misteri që rrethon vendndodhjen e mbetjeve të Hitlerit është ruajtur me qëllim. Ka historianë të cilët shkruajnë se për të shmangur konfliktet dhe kontradiktat, rusët, të cilët kishin zbuluar mbetjet e Hitlerit në fund të luftës, vendosën që ta mbajnë sekret vendndodhjen e tyre.

Sido qoftë ashtu, mori fund jeta e Adolf Hitlerit. Një keqbërës i jashtëzakonshëm i cili e zhyti njerëzimin në një luftë shkatërrimtare me mizori gjakatore. Një njeri i cili deklaronte se dashuronte artin dhe kulturën, por i cili ndërmoi fushatën më të pamëshirshme të gjenocidit që bota ka njohur ndonjëherë.

Por, Hitleri nuk ishte diktatori, vrastari i fundit i shekullit XX. Kishte të tjerë, ndër të cilët, historia veçon Stalinin i cili, aq mjeshtërisht doli ngadhënjyes nga Lufta e Dytë Botërore. I fundit diktator ndërsa, i shekullit XX ishte udhëheqësi serb, Slobodan Milloseviqi, i cili në natyrën e veprimit të tij politik kishte elemente të Hitlerit. Ndaj, nuk ishte e rastit përse në vitet e nëntëdhjeta, në faqet e para të shtypit perëndimor mund lexoheshin titujt e mëdhenj në të cilët konstatohej se "Milloseviqi e ka psikologjinë vrastare si të Hitlerit". Historianët e shekullit të XXI, ndërsa, kur do ta shkruajnë historinë politike të njerëzimit, gjithsesi, ndër diktatorët dhe vrastarët e këtij shekulli, padyshim, do ta radhisin Vladimir Putinin dhe të tjerë. Ndërsa, jemi të bindur se, historia moderne, politike, e Evropës Juglindore, e Ballkanit Perëndimor, në radhët e diktatorëve do ta vendos edhe bashkëpunëtorin besnik të Milloseviqit dhe të Putinit, presidentin serb, çetnikun, Aleksandar Vuçiqin, njërin nga antishqiptarët më të mëdhenj të politikës serbomadhe. (Fund)



# Albin Kurti e hapi kutinë e Pandorës. Nuk e mbyllë më dot!



Shkruan: Behxhet  
Sh. SHALA - BAJGORA

## Kur mbjellë egjër, korrë thera:

Çdo ditë po publikohen përgjime, me kryepersonazhe nga Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lista Serbe (LS), njëra fituese absolute e zgjedhjeve të vitit 2021, kurse tjetra, LS-ja, fituese absolute e të gjitha zgjedhjeve, që nga themelimi i saj, krejt falë partive shqiptare, pa veçuar asnjërin prej tyre. LS-ja është parti parlamentare me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që ia njeh Kushtetuta e Kosovës prandaj edhe nuk mund të përjashtohet nga proceset politike përjashtuar rastet kur vetëpërjashtohet. Të gjitha qeveritë para qeverisë Kurti 2 kanë bashkëpunuar me LS-në, kryesisht publikisht ndonëse nuk e përjashtoj mundësinë e marrëveshjeve jashtë syve të publikut. Për këtë, thuaja në çdo rast janë sulmuar verbalisht dhe fizikisht nga LV-ja duke u cilësuar si tradhtarë të kombit dhe shkatërrues të shtetit. Dhe, mbi këtë bazë kanë fituar vota që, në zgjedhjet e fundit e kalonin 50 për qind duke u veshur me pushtet absolut dhe mundësi për të bërë punë të mira për shtetin dhe qytetarët e saj, pa u penguar nga askush, opozita ishte e vdekur klinikisht. Kufomë politike, pa vullnet t'i nënshtrohet procesit të ringjalljes.

Albin Kurti dhe shërbyesja e tij, Vojsa Osmani, mendermethënë presidente, nuk lanë gjë pa kapur, qeveri, Kuvend, presidencë, borde, diplomaci, arsim, shëndetësi, ndërmarrje publike e private, media, OJQ, kishë a xhami, mbi tokë apo nëntokë, aty ka frymon jeta dhe shpresa, për t'i mbytur përfundimisht, pa shpresë ringjalljeje, sikur opozita aktuale. Albin Kurti e bëri qeverinë dhe Vojsën presidente me votat e Listës Serbe, me dashamirësinë e vëllait të Mimoza Kusarit, Millan Radojiçiqit.

Nuk shoh asgjë të keqe pse Lista Serbe ka votuar dhe se i janë përputhur interesat me LV-në, do të ishte jonormale t'i pamundësohej votimi. Edhe pse votat e LS-së ishin përcaktuese, nuk është e kundërligjshme. Në jetën e përditshme duhet të bëhet një dallim i qartë e sidomos në politikë midis ligjores dhe morale; shumë herë çka është e ligjshme, nuk përputhet me moralin dhe e kundërta. Bisedat e dekonspiruara midis Radojiçiqit dhe Mimoza Kusarit nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe për këtë (për aq sa janë bërë publike),

Mimoza Kusari nuk mund t'i nënshtrohet përgjegjësisë penale, në asnjë rrethanë. Mund t'i nënshtrohet përgjegjësisë politike qoftë përmes shkarkimit, dorëheqjes apo mosvotimit, në rast se është rezultat i përgjegjësisë morale, personale, partiake apo institucionale. Mirëpo, pasi LV-ja dhe koalicioni aktual qeverisës ka hequr dorë (për shkak të pushtetit) nga çdo parim njerëzor a moral, Mimoza del e pandëshkuar edhe në këtë rast sikur edhe për rastet në të ardhmen. Vet Mimoza, përgjegjësinë morale e ka shpallur non-grata që moti dhe nuk i bëhet vonë për asgjë. Te koalicioni qeverisës dhe Mimoza mund të kërkonte ç'të doni përveç moralit politik dhe përgjegjësisë. Atë çka Albin Kurti (lexo koalicioni qeverisës) e ka keq - mirë - përdorur për të ardhur në pushtet, me të gjitha mjetet, nga patriotizmi krejtësisht i rremë e deri te luftimi i opozitës, luftëtarëve të lirisë duke i dërguar në Hagë përmes dhe me ndihmën e LS-së, tash po i kthehet me një çmim shumëfish më të lartë, përmes LS dhe Millan Radojiçiqit, vëllait të Mimoza Kusarit dhe jo vetëm të Mimozës. Problemi rreth çështjes Radojiçiq është se ai po del të jetë faktori vendimmarrës nëse bie qeveria, nëse kalon paga minimale dhe nëse veteranët e UÇK-së do të përfshihen në këtë pagë a jo. Sekseri në këtë ndërmjetësim që për mua është krim njerëzor, politik e moral (kombëtarë po e përjashtoj shkakun se janë të zhveshur nga kjo përkatësi) është Mimoza kurse porositi është Albin Kurti. Dejana Mihali është ndërruese e pampersave (pelenave). Të pafytyrët.

## Eminenca, jo gri por skëterrë e pushtetit aktual, Dejana Mihali:

Tema kryesore e opozitës, mediave dhe "personave me ndikim" në Kosovë, që sa kohë është Dejana Mihali, një e dekluar në Shqipëri, e rilindur në Kosovë dhe e dashur në Greqi dhe Serbi. Në mesin e analfabetëve të LV-së, sillet si kryetare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve. Ua shkruan fjalimet, ua lexon fatin në filxhana, ua interpreton ëndrrat, i veshë me pushtet dhe i cullakosë nga pushteti, ua bënë terr para syve duke u ndalur rrymën, politikën e thella antikombëtare i mbështjellë me patriotizëm grek dhe serb, blenë dhe shet rrymë dhe zhvillon aktivitete që me asgjë nuk e ndihmojnë Kosovën dhe Shqipërinë. Edhe kësaj i dolën biseda duke e identifikuar si shefe të Albin Kurtit. Për anëtarët e LV-së, që duan poste dhe karrierë, më shumë kushton një foto me Dejana Mihalin se me Kim Kardashian. Është i pabesueshëm niveli i vartësisë së vartësve të Dejonës (lexo pushtetit aktual) ndaj kësaj

hipokrite e seksereje ku, edhe rrogëtarë më i bindur del të jetë më me dinjitet! Dikush thotë se Dejana është Kadri Veseli i LV-së, unë them se nuk është as sa një pordhë e Kadri Veselit. Kadri Veseli tërë jetën i ka kushtuar luftës për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar, kjo farë Mihaliçka e ka bërë të kundërtën, për Kosovën dhe shqiptarët e as për Shqipërinë nuk ka bërë asgjë hijë përveç dëmit. Nga Kosova vetëm ka përfituar, pameritueshëm dhe me një procedurë të korruptuar, shtetësinë, të mira materiale sikur që duket ka siguruar qëndrueshmëri afatgjate financiare në linjën terr - dritë të Bacës Martin (Berishaj), sekser serb, me imunitet diplomatik të Vojsa Osmanit, Albin Kurtit dhe Donika Shvarc.

Kjo seksere nuk e ka asnjë perspektivë, as në Kosovë e as në Shqipëri në kohën kur kungulli më nuk i shkon mbi ujë. Nuk ka pore institucionale që nuk i ka futur hundët, që nuk e ka shndërruar në kanalizim. Po mbrohet fort nga Albin Kurti, nga grupi i anarkistëve të Tiranës që duke tredhur miza në kafiteritë e Bllokut në Tiranë, marrin shumë para nga grazhdi i Albinit. Dejana Mihali nuk është nëntokë e Kosovës, është ferri vet për çështjen shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri, është eliksir i Greqisë dhe Serbisë. Është shqiptare për aq sa është edhe Fredi Beleri. Kjo Kosovën nuk e konsideron atdhe prandaj edhe do të largohet nga Kosova, jo si kapiteni i anijes (e fundit) por si minjtë e kanalizimit (e para). Kjo e ka marrë në qafë Albin Kurtin duke e drejtuar kah Greqia dhe duke e mësyre kundër

aleatëve dhe shqiptarëve të dëshmuar si patriotë. Kjo e ka mbjell farën e urrejtjes midis shqiptarëve. Vetëm sa nuk e kemi luftën vëllavrasje. Me Grupin Anarkist të Tiranës - tredhësit e mizave që paguhen nga Buxheti i Kosovës ka shkaktuar përçarje, deri në hasmëri midis Albin Kurtit dhe Edvin Ramës. Përmes rrogëtarëve, pa fije dinjiteti po manipulon me Policinë e Kosovës, Forcën Mbrojtëse dhe AKI- në. Për t'i luftuar kundërshtarët politik dhe patriotët e vërtetë. Ka edhe të tjera për këtë të dërguar nga ferri për t'ua bërë jetën ferr shqiptarëve.

**Po Albini..:** Albin Kurti i ka shkelur të gjitha parimet dhe premtimet. Nuk e them se është spiun i Serbisë, është tepër e rëndë. Por, as nuk e them se është përfaqësues dhe mbrojtës i interesave kombëtare. As shtetërore. Jam bukur i sigurt se do ta kryejë çdo detyrë që i japin ndërkombëtarët, pavarësisht dëmeve, vetëm për të mbetur në pushtet. Edhe një mandat. Bashkimin kombëtar e la në duar dhe vullnet të Alim Ramës, Eden Atiqit dhe Nenad Rashiçit. Sikur edhe flamurin kombëtar që po e trajton si kondom, e vendosë kur i duhet. Për këtë aktivistë të LV-së janë vrarë sikur që edhe janë vetëvuarë. Albin Kurti më nuk po mbrohet nga patriotët e vërtetë por nga ata që qençe i kanë shërbyer Serbisë dhe Jugosllavisë. Me 360 gramë kokainë të përzier i bëjnë përmendore. Dhunuesit e baballarëve të tyre e quajnë Albin Baba.

Del në fotografi me narkodilerë. Mbrohet nga analisti dhe profesori nga Amerika ndryshe

rrogëtarë i Rrahman Morinës, njeri i keq që tërë jetën ka qenë në strukturat serbe dhe jugosllave. Gjeneratat e reja nuk e njohin të kaluarën e këtij horri antikombëtar. Mbrohet nga dhunuesit e të miturave, për turp tash avokat, nga të dërguarit e UDB-së në Shqipëri që për pak nuk u emërua ambasador në Shqipëri, nga bijtë dhe bijat e milicëve dhe udhëbësve të Serbisë dhe Jugosllavisë dhe kriminelë që kanë dhunuar, arrestuar dhe vrarë patriotë shqiptarë. Në rrethana normale patriotike, Albin Kurti nuk do të pranonte përkrahjen e tyre, në rrethana të egra të luftës për pushtet, ndihma e ture del të jetë e domosdoshme. Prandaj, në këtë zinxhir të patriotizmit kombëtar nuk ka vend për yjet e përjetshme si Bacë Adem Demaçi dhe Adem Jashari. Vendin e tyre e kanë zënë Simiq, Radojiçiq, Mimoza Kusari dhe Dejana Mihali.

Turpëruese, deri në shashtisje! Po Kutinë e Pandorës e ka hapur Albini, nuk e mbyllë më, nuk mundet edhe po të doje. Asnjëherë nuk e kisha besuar këtë. Me Albinin askush nuk donë të bëjë koalicion, përveç Listës Serbe. Prandaj, në funksion të saj, si vlerë e shtuar janë Mimoza Kusari dhe Dejana Mihali, sa për fillim. Kosova, sipas një minorenit politik qenka përballur me rreziqe të mëdha dhe vetëm Peci e paska shpëtuar. Kurrë nuk kam besuar se një sen aq i vogël si peci luan rol aq të madh shtetëror dhe kombëtar. Nuk e di nëse ka përfunduar ultimatumit ndaj Abeldarit nga një rregëzinë që jargavitej zvarrë drejt një posti që me asgjë nuk e meriton! Vallë, çka do të bëhet pas kësaj?!



## Hapet Panairi Ndërkombëtar AGROKOS

PRISHTINË, 17 TETOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në hapjen e Panairit Ndërkombëtar AGROKOS, panairit me traditë 24-vjeçare, i cili jo vetëm që lidh bizneset dhe produktet me konsumatorët, por krijon një urë të fortë midis teorisë dhe praktikës për studentët dhe të rinjtë. Kryeministri tha se si qeveri, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm që e mbështesin zhvillimin e bujqësisë, përpunimin e ushqimit dhe prodhimin e pijeve, Kosova po bëhet gjithnjë e më shumë tërheqëse për investitorët. Sipas tij, investimet nga projektet strategjike të qeverisë, të kombinuara me faktorë të tjerë mbështetës, po na drejojnë në një e ardhmeje premtuese. Si faktorë mbështetës, ai veçoi stabilitetin institucional të vendit, rritjen mesatare ekonomike prej 6.2 % mesatarisht në tri vitet e fundit, afërsia me tregjet e Evropës Perëndimore, zhvillimi i projekteve infrastrukturore në sektorët e transportit, përparimi i sektorëve si bujqësia, përpunimi i



ushqimit dhe teknologjia informative, rinia e madhe, e talentuar dhe shumëgjuhëshe, si dhe energjia e lirë elektrike e mungesa e taksave doganore për

lëndë të parë dhe makineri prodhuese. E rëndësishmja e këtij panairi, sipas kryeministrit Kurti, medoemos që ishte edhe roli i

agrobiznesit në zhvillimin profesional të studentëve dhe të rinjve. "Kur arsimit dhe biznesit bashkëpunojnë, ndodhin mrekulli: studentët përfitojnë

afërsi praktike të vlefshme, ndërkohë bizneset fitojnë ide të freskëta dhe burime të reja pune. Sot agrobiznesi nuk është më thjesht një fushë tradicionale; inovacioni, digjitalizimi dhe intelijenca artificiale po ndryshojnë rrënjësisht mënyrën se si përparon bujqësia", deklaroi ai. Edhe përfshirja e grave në agrobiznes është një aspekt tjetër i rëndësishëm, tha kryeministri Kurti, sepse gratë tona janë ndërmarrëse të shkëlqyera dhe përmes bizneseve të tyre të vogla jo vetëm që fuqizojnë ekonominë lokale, por krijojnë zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale. Në fund, kryeministri Kurti ftoi të gjithë që ta shfrytëzojnë këtë panair për të krijuar lidhje të reja, për të ndarë ide dhe për t'i hulumtuar mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm. Ai e cilësoi panairin AGROKOS si shembull i mirë se si biznesi, arsimit dhe inovacioni mund të bashkëpunojnë për të ndërtuar një të ardhme të ndritur për Kosovën.

## Përfaqësues të bizneseve nga Kosova e Shqipëria u bëjnë thirrje të dy qeverive për bashkëpunim



PRISHTINË, 17 TETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë kanë mbajtur takim të përbashkët Kosovë - Shqipëri si mundësi e qëndrueshme e zhvillimit ekonomik. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, tha se ky takim ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit për ekonominë kombëtare dhe rritjen e konsumit të prodhimeve vendëse në Kosovë dhe Shqipëri. Shahini u bëri thirrje Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë të takohen dhe të bisedojnë për 100 marrëveshjet e nënshkruara, me qëllim të rritjes së ekonomisë të të dyja vendeve. Ai ka bërë me dije se mbi 600 biznese nga Kosova ekzistojnë në Shqipëri, por që tha se Kosova ka nevojë më shumë për importe nga Shqipëria, dhe anasjelltas: "Ekonomia kombëtare ka nevojë më shumë të jemi bashkë me vendime të ndryshme, në të dyja anët e shtetit tonë, në varemë dhe jemi si popull

konsumues të prodhimeve të huaja. Prodhuarit e vendit ballafaqohen me konkurrencë herë të padrejtë dhe moskonsum të prodhimit vendor. Misionet tona të përbashkëta janë për të bërë biznes të ndershëm dhe prodhim cilësor. Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë kanë nënshkruar mbi 100 marrëveshje të shumta prej tyre janë lënë në harresë. Andaj ftoj dy qeveritë që ta rrisin ekonominë kombëtare. Rrugë e kombit e ka lehtësuar qarkullimin e lirë të qytetarit, mallit dhe kapitalit. Kosova dhe Shqipëria duhet të konsolidohen, Kosova për gabimet e veta është nën sanksione ekonomike nga ShBA-ja, të cilat kanë ndikim negativ për ekonominë", ka theksuar Shahini. Nikolin Jaka, kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, ka theksuar se ndonëse të dyja vendet kanë prodhimtari, shkëmbimet tregtare mungojnë. Edhe ai ka kërkuar të rishikohen marrëveshjet e nënshkruara dhe të vlerësohen rezultatet.

## Nënshkruhet marrëveshja 22 milionë euro për zgjerimin e qasjes në financa për biznese

PRISHTINË, 17 TETOR - Është nënshkruar marrëveshja "Garancia për Ballkanin Perëndimor - mbështetja e qëndrueshmërisë së ndërmarrësve dhe MSME-ve" në mes të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) me vlerë 22.1 milionë euro për garantimin e kredive për ndërmarrjet në Kosovë, me theks të veçantë tek ato ndërmarrje në zona të

thella rurale. Në fjalën e tij përgjatë ceremonisë, ministri Murati theksoi se marrëveshja e nënshkruar sot do të mundësojë reduktimin e kostos së garantimit të kredive, duke e bërë më të lehtë për institucionet financiare të lëshojnë kredi si dhe më të lehtë për përfituesit që të kenë qasje në financa. Vlen të theksohet se nga 50 milionë euro që është vlera

totale e Bashkimit Evropian përmes kësaj iniciative mbështet Ballkanin Perëndimor, në kuadër të marrëveshjes së sotme, Kosova ka përfituar 22 milionë euro apo 45 % të vlerës totale. Marrëveshja e nënshkruar sot ndërmjet Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe KfW ka për qëllim zgjerimin e qasjes në financa dhe nxitjen e zhvillimit rajonal të balancuar.





# Harris-Trump, gjërat kanë ndryshuar

Në lidhje me zgjedhjet në SHBA, kemi parë një stuhë sondazhesh gjatë ditëve të fundit. Dhe këto sondazhe tregojnë shumë gjëra të ndryshme, dhe janë shumë sondazhe të ndryshme, dhe ka shumë shifra. Por duket se ka një tendencë që tregon se Kamala Harris ka humbur pak vrull në shtetet kryesore që janë edhe fushëbeteja e vërtetë. Kjo garë është jashtëzakonisht e ngushtë. Gjithmonë ka qenë e ngushtë. Është objektivisht më e ngushtë se sa ishte disa javë më parë.

Duket se jemi kthyer në një situatë me stabilitet relativ, pra një avantazh shumë i ngushtë i Harris në nivel kombëtar dhe pothuajse një barazim në shtetet e fushë-

betejës. Ishte ndryshe kur Harris u fut për herë të parë në garë.

Sigurisht që pas kandidaturës së saj kishte një vrull në fillim. Tani gjërat janë rikthyer aty ku ishin.

**Po cila është tema kryesore që po i jep avantazh Trumpit?**

**Ekonomia!**

“Kam ndërtuar një nga ekonomitë më të mëdha në historinë e botës. Dhe unë do ta ndërtoj përsëri. Do të jetë më e madhe, më e mirë dhe më e fortë”, u thotë ai

amerikanëve.

Dhe amerikanët duket se nuk i renditin të drejtat e abortit, që është çështja më e fortë e Harris, si prioriteti i tyre më i lartë.

Kemi parë Trump që ka fituar terren, veçanërisht në mesin e burrave dhe burrave me ngjyrë. Këto janë pika vërtet të dobëta për Kamala Harris.

Fushata e Harris e di këtë, dhe ata po bëjnë ç'të mundën për të luftuar, por duket se ish presidenti po e shfrytëzon. Dhe Trump ka atë që ekipi i Harris e konsideron një forcë befasese dhe madje shqetësuese mes burrave, duke përfshirë burrat me ngjyrë dhe burra latinë.

Demokratët janë befasuar nga qëndruesh-


mëria e koalicionit Trump. E vërteta është se shumë prej tyre menduan se kur Harris zëvendësoi Joe Bidenin, numrat e Harris thjesht do të rriteshin dhe do të qëndronin të pandryshuar.

Por, tre javët e fundit janë si një përjetësi në politikën amerikane. Miliona amerikanë kanë votuar tashmë, po, por ka dhjetëra miliona që ende nuk kanë votuar. Dhe votuesit e pavendosur janë peshë e madhe.

Por ama, shumë më të rëndësishëm tani janë njerëzit që vendosin nëse do të votojnë apo jo. Dhe këtu lajmet kanë rëndësi.

Këtu ka rëndësi bindja. Këtu kanë rëndësi reklamat. Këtu kanë rëndësi përpjekjet për të votuar. / bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Superliga rikthehet me ndeshjen Gjilani - Ferizaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINE, 17 TETOR - Superliga e Kosovës në futboll rikthehet sot (e premte) me ndeshjet e javës së nëntë. Elita e futbollit e Kosovës ishte në pushim për shkak të ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës, e cila arriti dy fitore në Ligën e Kombeve, duke i mposhtur Lituaninë dhe Qipron. Ndeshja e parë e Superligës zhvillohet sot mes Gjilanit dhe Ferizajt. Këto dy skuadra renditen në pozitën e shtatë dhe tetë dhe përipiqen të arrijnë fitore për t'u ngritur në renditjen tabelore. "Na pret një ndeshje e vështirë, pasi skuadra e Ferizajt ka në përbërje shumë futbollistë cilësorë. Ata kanë një skuadër të shpejtë në ofensivë. Ne si staf kemi pasur kohë dy javë për ta analizuar kundërshtarit dhe këtë kohë e kemi shfrytëzuar të punojmë si në aspektin teknik, po ashtu edhe në atë taktik. Në grup na pret një përballje e fortë dhe kur erdhëm këtë dihet se duhet ta japim maksimumin për t'i marrë tri pikë, të cilat janë shumë të rëndësishme për ne për të pasur ecuri të rezultateve pozitive", ka thënë Ardian Nuhiu, trajner i Gjilanit.

Të shtunën është derbi në mes të Malishevës dhe Prishtinës. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin "Liman Gegaj". Vendasit do të



provojnë të fitojnë dhe të vazhdojnë kryesimin në Superligë, në anën tjetër kryeqytetasit pritet ta japin maksimumin që t'i shkaktojnë telashe Malishevës dhe në këtë mënyrë të ngrehen në renditjen tabelore, pasi aktualisht janë në vendin e katërt me 4 pikë më pak se skuadra kryesuese, Malisheva, që ka 18 pikë. Të njëjtën ditë zhvillohet edhe ndeshja në mes të Feronikelit '74 dhe Dritës, me gilanasi që janë favoritë në këtë ndeshje. "Nikli" ka vetëm një pikë të grumbulluar dhe zë vendin e fundit në tabelë. Të dielën është derbi i dy skuadrave nga qyteti i Suharekës, Ballkani - Suharekës. Kampionët në fuqi të Kosovës janë në vend të tretë

me 14 pikë, kurse Suhareka e gjashta me 13 pikë. Ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo që zhvillohet në Klinë në mes të Dukagjinit dhe Llapit. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 13:00.

### SUPERLIGA / JAVA E NËNTË

**Të premtën takohen:**  
Gjilani - Ferizaj

**Të shtunën takohen:**  
Malisheva - Prishtina  
Feronikeli '74 - Drita

**Të dielën takohen:**  
Dukagjini - Llapi  
Ballkani - Suhareka

## Khaka: Nuk fjeta deri në 8 të mëngjesit pas humbjes nga Serbia

CYRIH, 17 TETOR - Kapiteni i kombëtares së Zvicrës, Granit Khaka, ka pranuar se nuk ka mundur të mbyllë sytë pas humbjes së kombëtares së tij ndaj Serbisë në Leskoc (2-0). Në një intervistë për RTS-në zvicerane, Khaka ka pranuar hapur para ndeshjes me danezët në Kopenhagën, e cila përfundoi pa fitues 2-2. "Të jem i sinqertë me ty, nuk kam fjetur deri në 8 të mëngjesit. Ishte një lojë shumë emocionale. Sido që të jetë, unë gjithmonë kam probleme me gjumin pas ndeshjes, veçanërisht nëse është humbje. Unë normalisht jam shumë autokritik, shikoj se çfarë kam bërë mirë dhe çfarë jo", ka shpjeguar Khaka për kanal zviceran. Kujtojmë që pas humbjes nga Serbia 2-0 në Ligën e Kombeve, trajneri i Zvicrës, Murat Yakin, u shpreh i pakënaqur, teksa tha se Serbia u tregua më e zgjuar se ata.



Më tutje, ai foli edhe për paraqitjen e Granit Xhakës. "Granit ishte i pranishëm si gjithmonë. Ai e drejtoi lojën. Nuk ishte vetëm ai. Luajtëm mirë për 40 minuta. Bëmë një ose

dy gabime të pafalshme në mbrojtje, duke lejuar goditje standarde. Ata po prisnin për këtë. Ishte më e zgjuar nga ana e tyre", ka thënë Yakin.

### SHKURT

#### Besa Famgas është gati për ndeshjen në Çeki

Për herë të 19 Besa Famgas paraqitet në gara kontinentale për hendbollistë. Prej kur debutoi ndaj Bevo Panningenit të Holandës më 3 shtator 2005, Besa vetëm një herë ka munguar nga garat evropiane. Këtë edicion paraqitet në Kupën Evropiane, kurse garimin e nis prej raundit të dytë. Skuadra pejane takohet me skuadrën çeke Mesto Lovosice. Ndeshja e parë është të shtunën me fillim nga ora 17:00 në Lovosice të Çekisë. Ndeshja e kthimit është më 27 tetor në "Karagaçi", kurse Besa e synon avancimin evropian të radhës. Besa ka bërë kombinim të lojtarëve me përvojë me lojtarët me potencial dhe kjo formulë shpresohet të japë rezultat ndaj skuadrës çeke.

#### Rahoveci për herë të dytë në Evropë

Kampioni i Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve, KH Rahoveci, është gati për paraqitjen e dytë në gara evropiane. Në raundin e dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup), Rahoveci përballet me skuadrën belge Sezoens Achilles Bocholt. Ndeshja e parë është të shtunën nga ora 20:15 në Bocholt të Belgjikës. Pas sukseseve historike, titullit të kampionit dhe triumfit në Superkupë, "vreshtarët" synojnë suksesin e parë në gara kontinentale. Para dy vitesh Rahoveci luajti dy ndeshje të forta me skuadrën çeke Karvina. U mposht me rezultat të ngushtë dhe nuk ia doli të avancojë. Rahovecasit kanë nisur mirë edicionin dhe presin që formën ta konfirmojnë në Belgjikë e pas një jave edhe në "Mizahir Isma", para tifozëve të tyre.

#### Shqipëria dhe Kosova ngrehen në renditjen e FIFA-s

Dy ndeshjet e fundit të Kombëtares (humbja me Çekinë dhe fitorja me Gjeorgjinë) kanë bërë që kuqezinjtë të fitojnë dy pozicione në renditjen botërore. FIFA do të publikojë gjithçka më 24 tetor, teksa sipas një përlllogaritje nga faqja e specializuar "Football Meets Data", kuqezinjtë do të ngjiten në pozitën e 65 në botë, nga vendi i 67 që mbajnë për momentin. Ngjitje edhe për Kosovën, e cila nga vendi i 104 do të pozicionohet në 101, pas tri fitoreve radhazi në Ligën e Kombeve. Ecuria e mirë e "dardanëve" po shpërblehet, me përfaqësuesen e Kosovës që ka një përballje kundër Rumanisë në nëntor për kreun e grupit. Ndërkohë, kombëtarja shqiptare luan kundër Çekisë dhe Ukrainës më 16 dhe 19 nëntor në "Air Albania", dy ndeshjet e fundit në Grupin B1 dhe është në garë për kreun e tabelës.

#### KB Trepça pëson humbje nga MHP Riesen Ludwigsburg

Kampionia e Kosovës, Trepça, ka pësuar humbje nga MHP Riesen Ludwigsburg me rezultat 57:70 (21:21, 11:14, 13:12, 12:23), në grupet e FIBA Europe Cup. Çereku i parë ishte kryesisht i baraspeshuar, me të dyja skuadrat që nuk arrinin të shkëputeshin dhe kjo pjesë përfundoi 21:21. Edhe periudha e dytë ishte e baraspeshuar, por me shumë gabime, duke u shënuar shumë pak pikë, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 32:35. Por, dallimi u bë në pjesën e dytë. Skuadra gjermane ishte më e mirë, sidomos në momentet vendimtare dhe arriti të fitojë 57:70. Dardan Kapiti ishte më i miri te vendasit me 11 pikë e nëntë kërcime. Për kampionët e Kosovës ishte humbja e dytë në dy ndeshje, kurse për mysafirët fitorja e dytë në dy ndeshje. Takimin e ardhshëm "Xehetarët" e kanë në shtëpi ndaj Caledonia Gladiators më 23 tetor.

## Mbappe pranon se ka pasur një marrëdhënie

Stokholm, 17 tetor - Kylian Mbappe ishte mungesa e madhe e Francës në dy sfidat e tetorit në Ligën e Kombeve, por emri i tij vijon të bëjë xhiron në media, për faktin se mbi sulmuesin e Real Madridit rëndon një akuzë e fortë për përdhunim. Menjëherë sapo ky

lajm u bë publik, Mbappe, me anë të përfaqësuesve të tij, nxituan duke thënë se ishte një "fake news", por tani është vetë lojtari që bën hapa pas duke pranuar se ka pasur një marrëdhënie në hotelin e kryeqytetit suedez, por ky ka qenë një raport konsensual.

Denoncimi sipas përfaqësuesve të tij ka ardhur nga një tjetër femër. "Le Perisien" ka provuar të ndërtojë nga e para këtë histori duke analizuar faktet. Fakt është që Mbappe ka qenë në Stokholm, ka qenë në atë hotel ku është zhvilluar një festë private.

Francezi ka pasur një marrëdhënie me një femër, por jo kundër dëshirës së saj. Denoncimi për përdhunim dhe ngacmim ka ardhur në zyrat e Prokurorisë nga një tjetër femër. Pavarësisht se kanë kaluar katër ditë që kur është bërë denoncimi, as



Mbappe as përfaqësuesit e tij nuk janë informuar për këtë zhvillim të ri.

## Batatina: Po t'u besohej më herët lojtarëve të Superligës, do të ishim kualifikuar në evropian

PRISHINË, 17 TETOR - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka shprehur bindjen se po të kishin pasur lojtarët e Superligës së Kosovës besimin e trajnerëve të kombëtares, do të ishin vendimtarë që Kosova të ishte pjesë e Kampionatit Evropian apo edhe Botëror. Në ndeshjen ndaj Qipros ishin tetë lojtarë që kanë dalë nga Superliga në formacionin startues të Kosovës, lajm ky që Batatina e ka vlerësuar jashtëzakonisht shumë. "Mendoj që është dashur më herët të veprohet kështu dhe komplimente për selektorin që është tani për shkak se u ka besuar lojtarëve të Superligës, lojtarë që kanë dalë nga liga jonë dhe shumë shpejt janë inkuadruar te kombëtarja. Po të kishte ndodhur ndoshta më herët ishim kualifikuar në evropian që patëm, edhe në Botëror. Mendoj se neglizhenca dhe mosrespektimi i Superligës së Kosovës ka ndikuar që ne të mos kualifikohemi në asnjë prej kampionateve botërore dhe evropiane", ka deklaruar Batatina. Më tutje, trajneri i Llapit ka thënë se është shumë i kënaqur me



rezultatet e arritura nga "dardanët" në ndeshjet e fundit, por ka kërkuar që të synohen edhe dy fitore në muajin nëntor. "Besoj se kemi bërë paraqitje të mirë, dy ndeshje, dy fitore. Kemi mundësi edhe të përmirësohet kombëtarja jonë. Shpresoj të përmirësohet duke e ditur që trajneri tani e ka mundësinë t'i njohë për së afërmi lojtarët për cilësitë, kualitetin dhe çfarë duhet të ndryshojë. Normalisht që jemi shumë të kënaqur kur kombëtarja jonë ka arritur dy fitore dhe pse jo ta presim

muajin nëntor dhe ta arrijmë objektivin dhe t'i marrim edhe dy fitore të radhës dhe të kualifikohemi më tutje duke e ditur që Kosova ka potencial, ka një skuadër shumë të fortë dhe mendoj se është gjynah nëse na ikën edhe ky kualifikim dhe të mos jemi aty ku e meritojmë sepse kemi lojtarë shumë cilësorë", ka theksuar Batatina. Rugëtimin në Ligën e Kombeve, Kosova e mbyll me ndeshjet ndaj Rumanisë dhe Lituanisë që zhvillohen më 15 dhe 18 nëntor.

## Futbollistët më të paguar sipas 'Forbes', kryeson Ronaldo me 285 milionë dollarë

JERSEY CITY, 17 TETOR - Revista "Forbes" ka publikuar listën e futbollistëve më të paguar në botë. Në vendin e parë renditet sërish Cristiano Ronaldo. Portugezi fiton aktualisht 285 milionë dollarë (rreth 263 milionë euro), nga të cilat 220 vijnë nga Al-Nasr dhe 65 nga burime të tjera të ardhurash. Në vendin e dytë renditet Lionel Messi me fitime prej 135 milionë dollarësh dhe në pozitën e tretë vijon Neymar, sulmuesi i Al-Hilal që fiton 110 milionë dollarë në vit. Karim Benzema, me një pagë prej 104 milionë tek Al-Itihad dhe Kylian Mbappe, me 90 milionë dollarë, renditet si evropiani i parë në këtë renditje të hartuar nga gazeta e njohur ekonomike. Në top 10 janë Erling Haaland i Manchester City



(60 milionë), Vinicius Junior i Real Madrid (55 milionë), Mohamed Salah i Liverpoolit (53 milionë), Sadio Mane i Al-Nasr (52 milionë) dhe Kevin De Bruyne i City (39

milionë). Kjo listë nxjerr në pah jo vetëm potencialin e madh ekonomik të futbollit modern, por edhe ndikimin e kampionatit saudit në kontekstin global të futbollit.

### SHKURT

#### Messi: Lautaro Martinez e meriton 'Topin e Artë'

Pas tri golave të shënuara në fitoren 6-0 të Argentinës përballë Bolivisë, Lionel Mesi ka lobuar për shokun e tij të repartit sa i përket garës për "Topin e Artë". "Për Lautaro Martinezin nuk mund të them gjë tjetër veç fjalëve të mira. Ka zhvilluar një sezon shumë të mirë. Në Kupën e Amerikës shënoi gol në finale dhe përfundoi turneun në majën e klasifikimit të golashënuesve. Meriton "Topin e Artë", ka thënë Mesi. Lautaro vjen pas një sezoni shumë pozitiv me Interin, por në aktualin nuk është se ka bërë shumë mirë.

#### Pogba: Jam gati të luaj edhe pa para për Juventusin

Paul Pogba është gati të rikthehet në fushën e lojës pas pezullimit të gjatë dhe këtë gjë kërkon ta bëjë me Juventusin. Edhe pse ditët e fundit është folur shumë për një mundësi që klubi torinez ta mbyllë kontratën me të, ylli francez është gati të luajë edhe pa para. "Jam gati t'i rikthehem normalitetit. Jam më i uritur, më i pjekur dhe më i fortë. Kam vetëm një dëshirë, të rikthehem të luajë futboll. Në kokën time është vetëm kjo, por kam dëshirë të flas në fushë. Tek Juve dhe Franca dëshiroj të jem më i miri. Jam i gatshëm të heq dorë edhe nga paratë", ka thënë francezi. Pogba ka një pagë sezonale prej 10 milionë eurosh, një shifër që për Juve është shumë e lartë në këtë kohë. Nga ana tjetër, Motta nuk e sheh si pjesë të projektit, as drejtuesit e klubit, për këtë arsye nuk parashikohet një rikthim i tij në mars të 2025-s.

#### Gazetari i njohur spanjoll: Mbappe ka probleme me alkoolin

Gazetari Romain Molina ka dhënë një lajm të befasishtëm për sulmuesin e Real Madridit, Kylian Mbappe. Sipas tij, ylli francez po përjeton probleme serioze me shëndetin mendor. Ai pretendon se 25-vjeçari është parë shpesh duke dalë në klube nate dhe është përdorues i shpeshtë i alkoolit, gjë e pakonceptueshme për një futbollist profesionist. Komentet e gazetarit kanë sjellë shumë reagime në rrjet, por Real Madridi ende nuk ka një reagim zyrtar. Mbappe këtë periudhë ka pasur shumë presion, sepse prej tij pritet shumë.

#### Bayerni interesohet për Deniz Undav

Bayern Muncheni është prej kohësh në kërkim të një përforsimi të nivelit të lartë për ta mbështetur Harry Kanen në sulm. Ndër emrat e konsideruar, spikat ai i Deniz Undav, sulmuesi 28-vjeçar që po paraqitet mirë në Bundeliga me skuadrën e Shtuttgartit. Paraqitjet e tij pozitive kanë tërhequr vëmendjen e klubit bavarez, i cili po mendon për një transferim të mundshëm. Madje që në merkaton e janarit. Lojtari ka një kontratë me Shtuttgartin deri në qershor të vitit 2027. Kjo e bën të ndërlikuar çdo negociatë, duke marrë parasysh edhe fillimin e mirë të sezonit të klubit gjerman (lojtari ka realizuar 6 gola në 10 ndeshje në total deri më tani). Megjithatë, Bayerni mund të vendosë të bëjë një ofertë në muajt e ardhshëm. Blerja e Undav mund të përfaqësojë një përforsim të rëndësishëm për Bayernin, i cili duhet ta forcojë sulmin. Skuadra ka mjaft probleme kur nuk është Harry Kane, që kohët e fundit ka munguar për shkak të një problemi fizik.

## Reali synon transferimin e Arnoldit, Barça pas dyshes Tah - Davies


Në Spanjë, dy ekipet e mëdha, Real Madridi dhe Barcelona, priten të jenë sërish aktive në tregun e transferimeve. Ekipi i Carlo Ancelottit kërkon një anësor të djathtë, pasi Carvajal mbylli sezonin. Edhe pse

drejtuesit e klubit konfirmuan besimin ndaj kapitenit, duke i rinovuar kontratën deri më 2026, është e qartë që tekniku italian ka nevojë për një anësor të ri. Prej kohësh, Reali ndjek nga pranë mbrojtësit anglezë Trent

Alexander - Arnold. Nuk bëhet fjalë për një blerje emergjente pasi Arnold është një objektivi afatgjatë, por dëmtimi i Carvajal thjesht i detyron t'i përshejtojnë negociatat. Me sa duket, Reali ka marrë bekimin e lojtarit pasi

Arnold ka vendosur të mos rinovojë kontratën e tij me Liverpoolin. Kjo lëvizje "alla" Perez e detyron Liverpoolin të futet në negociatë që në janar, për të mos rrezikuar më pas ta humbasin falas. Ndërkohë, në

shtëpinë e Barcelonës kanë kthyer vështrimin nga Bundesliga, pasi aty janë dy synime, Jonathan Tah e Alphonso Davies. Me bekimin e Hansi Flick, drejtuesit e Barcelonës do të tentojnë t'i afrojnë dy futbollistët.

  
Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

**CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE**

---

**NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202046-02005K-0**

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	18-484-48640/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	16.10.2024 - 15:34
Komuna / Opština / Municipality:	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRRI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Maxhunaj / Maxhunaj / Maxhunaj
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRRI

**A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA**

Numri i njësive kadastrale / Broj katastarske jedinice / Cad. Unit. No.	Lloji i njësive / Vrsta Jedinice / Unit Type	Lloji i pronës / Vrsta imovine / Property Type	Zona / U/R / G/S / U/R	Sipërfaqja / Përfaqja / Površina / Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim / Opis / Description	Krijuar më datën / Uradjeno na dan / Created On	Azhuruar / Azurirano / Updated
P-70202046-02005K-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Prone private / Privata Imovina / Privately owned Land	Rural	4433		15.10.2024	

**A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS**

Vendi i quajtur / Mesto zvano / Called place	Kodi Postal / Poštanski Kod / Postal Code	Emri i rrugës / Naziv ulice / Street name	Krijuar më datën / Uradjeno na dan / Created On	Azhuruar / Azurirano / Updated
T-687			15.10.2024	

Printuar nga / Odstampani od / Printed by: Yiber Maxhuni | P-70202046-02005K-0 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

**JI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Lloji i shfrytëzimit të parces / Vrsta koriscenja parcele / Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parces / Trenutno koriscenje parcele / Parcel Current Use	Kualiteti i klasës / Kvalitet klase / Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) / Površina (m <sup>2</sup> ) / Area (m <sup>2</sup> )
Bujësi/Poljoprivreda/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Acë E Klasës 4/Njiva 4 Klasse/4th Class Arable Land	4433

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat / Prava / Rights	Emri / Ime / Name	Nr. personal / Licni broj / ID. No.	Vendbanimi / Prebivalise / Resident	Kodi postal / Poštanski kod / Postal code	Hollësitë e adresës / Pojednostni adrese / Address details	Pjesë e pronës / Deo imovine / Share quota	Përshkrimi / Opis / Description	Azhuruar / Azurirano / Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Maxhuni Ajete (Rasim)	1244588529	MAXHUNAJ / MAXHUNAJ / MAXHUNAJ		Maxhunaj	1/1	F.T nr.130 nga Aktiviteti i komasacionit	16.10.2024

Printuar nga / Odstampani od / Printed by: Yiber Maxhuni | P-70202046-02005K-0 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Balkan Shoes Slippers and Other Leather Products Industry and Trade” L.L.C. Suharekë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin të këpucëve në Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.12.2024 në ora 11:00 në Shkollën e Mesme Teknikë "Skender Luarasi" në Suharekë do të organizohet debat publik nga Kompania “Balkan Shoes Slippers and Other Leather Products Industry and Trade” L.L.C. Suharekë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Balkan Shoes Slippers and Other Leather Products Industry and Trade” L.L.C. Suharekë për fabrikën për prodhimin të këpucëve në Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alberita Kuqi nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m.” Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Mirlind Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e.”Kadri Kusari” Gjakovë.
- Dion Kazazi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t.”Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Danjell Gjini shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Lidhja e Prizrenit “ Prizren.
- Saide Likaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Mic Sokoli “ Lubeqev.
- Nashide Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Fadil Hisari “ Prizren.
- Majlind Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10 të shkollës së mesëm Ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**

